

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

## “Auto Dosti” shpk

Fier më datë 15/07/2024

### NENI 1

Shoqëria Tregtare “Auto Dosti” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

### NENI 2

#### Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “Auto Dosti” sh.p.k

### NENI 3

#### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e veprimtarive në fushën e tregtise, dhenies me qira dhe sherbime per automjetet, konkretisht:

- 1) Import-eksport, tregtim automjetesh të reja dhe të përdorura të të gjitha llojeve.
- 2) Dhenie me qera dhe marje me qera nga pale te treta.
- 3) Import-eksport, tregtim i pjesëve të këmbimit për automjete të ndryshme.
- 4) Servis dhe riparim automjetesh.
- 5) Import Eksport gomash të reja dhe të përdorura.
- 6) Dhënie me qira të automjeteve të ndryshme.
- 7) Lavazh.
- 8) Kurse kualifikimi për funksionimin dhe riparimin e automjeteve të të gjitha tipeve.
- 9) Import- Eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë e pakicë industriale, etj.
- 10) Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash për vete, për të tretë, e me qira.
- 11) Për të arritur objektivat e saj, kompania mund të kryejë gjithashtu çdo operacion tregtar, industrial, mobiliare, imobiliar dhe financiar të nevojshëm dhe të domosdoshëm për përmbushjen e qëllimit social, brenda kufijve ligjore.
- 12) Kryerje transaksionesh brenda dhe jashte vendit per blerje dhe shitje te makinave

### NENI 4

#### Selia e Shoqërisë

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë: Fier , Lagjja "16 Prilli", Rruga "Leon Rei", godina 27, H. 1, Ap. 9, Nr pasurie: 6/36+1-9
- 2) Adresa e komunikimit elektronik të shoqërisë është: xhesiondosti@gmail.com

### NENI 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 2.000.000 lekë. Kapitali ndahet në 1 (nje) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

- 1) Xhesjon Dosti në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 pjese (kuote) me vlerë 2.000.000 lekë .

Kapitali themeltar investohet nga ortaku themelues në para. Pagesa e kapitalit themeltar kryhet nga Ortakët themelues mbas rregjistrimit ne Qëndren Kombëtare të Biznesit.

#### **NENI 6** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. **Kohëzgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat.**

#### **NENI 7** **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administrator – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për **një afat pesë vjeçar** me të drejtë rizgjedhjeje.

**Administratori i parë i shoqërisë është z. Xhesjon Dosti**, lindur më 26.12.1993 në Libofshë, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr.035164489 dhe nr. personal J31226062B.  
cel.00355 692084901.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

#### **NENI 13**

Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

#### ***ORTAKËT***

##### ***E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

##### **Auto Dosti**

- 1.Ortaku i vetëm themelues  
Xhesjon Dosti